REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçante

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.** **Tiranë ___/___/2015**
Nr. Dok. 201501155/2

Lënda: *Rekomandojmë marrjen e masave për marrjen në dorëzim të dënuarit M. M. Rr. I paraburgosur në dhomat e sigurisë dhe i arrestuar në bazë të vendimit gjyqësor të formës së prerë.*

Drejtuar : **Z.Artur ZOTO**
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve
TIRANË

***I nderuar Zoti Zotaj*,**

Gjatë inspektimit të kryer në Komisariatin e Policisë Vlorë, me datën 30.06.2015 u konstatua se në bazë të vendimit gjyqësor të formës së prerë, me Nr.366 datë 08.07.2014 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Vlorë, është arrestuar shtetasi ***M. Rr.*** i cili për arsye shëndetësore është shtruar dhe tani ndodhet i shtuar në Spitalin Rajonal Vlorë.

Nga ana e Komisariatit Policisë Vlorë, rezultoi se është dërguar shkresë me datën 09.06.2015 Drejtorisë Përgjithshme të Burgjeve, duke u kërkuar trasnferimi i tij në vendin e vuajtjes së dënimit dhe nga ana juaj akoma nuk është marrë asnjë masë për të bërë këtë transferim.

Meqenëse ky rast duhet verifikuar dhe në përshtatje me gjendjen shëndetësore të tij duhen marrë masa të menjiherëshme për marrjen në dorëzim dhe vendosjen e tij ose në Qendrën Spitalore të Burgjeve Tiranë, ose në në I.E.V.P. në përshtatje me veprën penale të kryer dhe vendin e banimit të tij, dhe se nga ana juaj nuk janë marrë masat e nevojshme, ka vend që nga ana jonë të ndërhyhet me rekomandim.

Duke analizuar këtë rast konkret dhe duke u bazuar në kërkesat e nenit 63 pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se:"***Avokati i Popullit ka të drejtë të bërë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut, nga administrata publike***", dhe të neni 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999"Për Avokatin e Popullit", ku thuhet se, *pas përfundimit të hetimit* ***:" Avokati i Popullit paraqet rekomandim për vënien në vend të së drejtës së shkelur nga organi administrativ, që sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive***",

Për sa më sipër, Ju

R E K O M A N D O J Ë :

1.Marrjen e masave për marrjen në dorëzim të dënuarit M. M. Rr. nga dhomat e sigurisë të Komisariatit Policisë Vlorë, duke e trasnferuar në Qendrën Spitalore të Burgjeve Tiranë, ose në I.E.V.P. sa më afër vendbanimit tij.

2.Mbi masat e marra nga ana juaj në bazë të nenit 22 të Ligjit me Nr.8454 datë 04.02.1999"Për Avokatin e Popullit", lutemi na njoftoni me shkrim brenda 30 ditëve.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI